



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 49/23

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Kimete Gashi-Kryetare duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "El-Bau" sh.p.k., me seli në Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadish", me nr. të prokurimit: 651-22-11628-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna Gjilanit, me datën 07.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

- Aprovohet**, si e bazuar ankesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik "El-Bau" sh.p.k., me seli në Gjilan, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 20.01.2023 (me numër protokollit 49/2023) për aktivitetin e prokurimit "Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadish", me nr. të prokurimit: 651-22-11628-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Komuna Gjilan.
- Anullohet**, Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i dates 11.01.2023, për anulim të aktivitetit të prokurimit të sipër shënuar, ndërkaq aktiviteti i prokurimit me të dhënat si më sipër kthehet në rivlerësim.
- Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj Panelin Shqyrtues të OSHP, për gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi. Në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar).

4. Me qenë se ankesa e Operatorit Ekonomik “El-Bau” sh.p.k., aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

5. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 11.01.2023, Komuna Gjilan, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadish”, me nr. të prokurimit: 651-22-11628-5-2-1.

Me datë 16.01.2023, Operatori Ekonomik “El-Bau” sh.p.k., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK-Komuna Gjilanit, me datë 18.01.2023, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të publikuar në platformën e prokurimit elektornik me datë 11.01.2023.

Me datën 22.12.2022 Operatori Ekonomik “El-Bau” sh.p.k., ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 49/2023, kundër njoftimit mbi vendimin e AK për anulim të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00 €

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 02 shkurt 2023 me raportin e ekspertizës. AK Komuna Gjilanit, me datë 06.02.2023, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa me datë 06.02.2023 OE “El-Bau” sh.p.k., ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit

të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 02.01.2023, ekspertja shqyrtuese ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa OE "El-Bau" sh.p.k., me seli Gjilan të aprovet pjesrishtë si e bazuar.

- të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 11.01.2023.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "El-Bau" sh.p.k., me seli Gjilan

OE i pa kënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues paraqet ankesë në OSHP, me arsyetimin se janë shkelur dispozitat ligjore të LPP-së,

Eksperti shqyrtues, sqaron se autoriteti kontaktues pas pranimit të ofertave në sistemin e e-prokurimit, ka formuar komisioni për vlerësimin e ofertave i cili ka konstatuar se ka gabime në listën e përshkrimit të çmimeve - paralogari dhe paramasë dhe se ky gabim sipas komisioni vlerësues në këtë fazë është i pariparushem. Me datën: 11.01.2023 zyrtari përgjegjës i prokurimit e publikon në sistemin e e-prokurimit, njoftimin mbi vendimin në AK-se, me të cilin e anulon në tërësi aktivitetin e prokurimit në fjale.

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar paramasën ka vërejtur se, AK-ja, nuk e ka dhënë formulën në të gjitha pozicionet e paramasës, konkretisht krahut nr. 3 dhe për pasojë nuk është llogaritur fare.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues e ka vërejtur dhe ka ndërhyrë në paramasë duke e llogaritur edhe totalin e krahut nr. 3 të paramasës, ndërsa OE i dyti me radhë e ka vendosur çmimin e në krahun nr. 3 por si pasojë e gabimit në formulën e paramasës nuk është llogaritur totali dhe në këtë mënyrë OE-të, që nuk e kanë vërejtur nuk kanë qene të barabarte në këtë aktivitet të prokurimit.

Eksperti shqyrtues, vjen në përfundim se AK-Komuna e Gjilanit me rastin e hartimit të dosjes së tenderit konkretisht paramasës, nuk ka vepruar në harmoni me nenin 27 të LPP-se dhe njëherit sqaron se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet sepse dosja e tenderit është hartuar në kundërshtim me nenin 27 të LPP-së, konkretisht në kundërshtim me nenin 47.14 të RrUOPP-se, citat:

47.14 Autoriteti kontraktues duhet të marrë një qasje të ngjashme jo-kufizuese kur zbulon se dosja e tenderit që ka lëshuar mund të ketë mangësi të caktuara ose mund të jetë më pak e qartë në disa pika. Kjo megjithatë nuk duhet që në asnjë rrethanë të çojë në ndonjë ndryshim defacto në kërkesat teknike dhe të tjera të dosjes së tenderit. Nëse autoriteti kontraktues vjen nëpërfundim se tenderi i planifikuar është në fakt i papërshtatshëm atëherë ajo nuk do të ietë e mundur për të "riparuar" në dosjen e tenderit me anë të informacionit shtesë ose sqarime. Qasja e vetme në dispozicion në situata të tilla është që të anulohet tenderin dhe të fillojë një procedurë tjetër në bazë të një dosje të tenderit të ndryshuar si dhe marrjes përfundimtare të vendimeve, nuk ka përfunduar brenda afateve ligjore, duke cituar se: nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK-së do të kryhet brenda periudhës

me të shkurtër kohore, jo me shume se 30 dite nga hapja e ofertave. Nga procesi i hapjes se tenderit me datën 05.12.2022 dhe deri te nxjerrja e vendimit për anulim te aktivitetit ka zgjatur 37 dite.

Eksperti shqyrtues për pretendimin e cituar me larte, vlerëson se qëndron për faktin se sipas nenit 41.2 të RrUOPP-se, vlerësimi i ofertave do te zgjasë jo me shume se 30 dite dhe duhet te filloje brenda 5 ditëve pas hapjes se ofertave.

OE ankuese, pretendon se pas pranimit të vendimit të datës 11.01.2022 për anulimin e aktivitetit të prokurimit: Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Gadish, është kërkuar qasje në dokumente zyrtare nga AK. Pas aprovimit të kërkesës nga AK për qasje në dokumente zyrtare, OE ankues konsideron që: nuk është lejuar qasja ne dosjet tenderues siç parashihet ne nenin 10 dhe 11 të LPP-së, me arsyetimin se është parashtruar kërkesë për sekrete afariste. OE pretendon se OE “Company Zuka” dhe OE “ Tali” ne asnjërën prej kërkesave të tyre nuk janë identifikuar/referuar dokumente apo informacione si sekrete afariste si dhe nga Autoriteti Kontraktuese nuk është kërkuar nga OE ne fjalë qe te plotësojë formularin e Anex-it 3.

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim sqaron të dy OE-të për të cilët ka pretenduar OE ankues, i kanë dorëzuar kërkesat për sekret afarist, të cilët në kërkesat e tyre, i kanë përcaktuar të gjitha kërkesat mbi mundësit ekonomike dhe financiare dhe kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale.

Sa i përket këtij pretendimi eksperti shqyrtues sqaron se qëndron ky pretendim i OE ankues, për faktin se nuk mund të kualifikohen të gjitha dëshmit e kapacitetit teknik dhe profesional si sekrete afariste.

Aneksi 3 Kërkesa për sekret afarist

Për: Kuvendi Komunal-Gjilan

(më tej “Autoriteti Kontraktues”)

Duke pasur parasysh se “Company Zuka Commerce”sh.p.k , duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën nr. e prokurimit të sipër-përmendur, paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

Oferta financiare, dokumenti mbi gjendjen ekonomike dhe financiare dhe dokumenti mbi mundësit teknike dhe profesionale. ::

Aneksi 3 Kërkesa për sekret afarist

Për: Kuvendi Komunal- Gjilan (më tej “Autoriteti Kontraktues”)

Duke pasur parasysh se me tej "Operatori Ekonomik duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën nr. e prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

Oferta financiare dokumenti mbi gjendjen ekonomike dhe financiare dhe dokumenti mbi mundësit teknike dhe profesionale.

Eksperti shqyrtues në fund të vlerësimit të pretendimeve ankimore, sqaron se ankesa është pjesërisht e bazuar lidhur me shkeljet procedurale të cilat u sqaruan më larte, ndërsa pretendimi kryesor lidhur me anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit nuk qëndron për faktin se gjate përpilimit të dosjes së tenderit nuk janë respektuar dispozitat e nenit 27 te LPP-se dhe neni 47.14 te RrUOPP-se.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “El- Bau”, të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit të mbetet në fuqi.

Konvokimi i seancës dëgjimore me palë

Paneli shqyrtues me datën 02 prill 2023, ka mbajtur seancën dëgjimore në të cilën është bërë shqyrtimi dhe analizimi i të gjitha shkresave të lëndës.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues deklaroj: Në cilësinë e përfaqësuesit të kompanisë El Bau Sh.p.k., do të përpiqem që të jam lakonik në paraqitjen e kësaj fjale përfundimtare, i bindur se ju e keni analizuar gjithë dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës në këtë çështje, andaj e rikonfirmojmë se mbetemi në tërësi pranë thënieve dhe pretendimeve të parashtruara në ankesën e dt. 20.01.2023 si dhe përgjigjes në Raportin e Ekspertit Shqyrtues Nr. 49/23 të dt. 02.02.2023, duke konsideruar se justifikimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit është i paqëndrueshëm dhe i pabazuar, për shkak se, me vendimin e kontestuar është bërë vërtetim i gabuar i gjendjes faktike dhe aplikim i gabueshëm i dispozitës së ligjit material, konkretisht nenit 62 par.1.1 i LPP-së Nr. 04/L-042.

Pasqyrimi i gabueshëm i gjendjes faktike që nuk përkon me realitetin, paraqitet duke ngritë versione me supozime të pabaza me qëllim të ngatërrimit të gjendjes faktike përmes sajimit të fakteve të rreme për anulim të aktivitetit gjersa procesi ishte në fazën e dhënies së kontratës, me arsyetimin se kinse ka ndodhur një gabim i pariparueshëm tek lista e përshkrimit –paramasës dhe parallogarisë.

Për vëmendjen tuaj e shoh të nevojshme që shkurtimisht të vë në dukje se, baza e anulimit në të cilën është thirrur AK-ja nuk qëndron në mënyrën e paraqitur sepse e vërteta është krejt ndryshe nga ajo që pasqyrohet në vendimin e kontestuar të AK-së. Sepse nuk ekziston asnjë gabim në PJESËN C, formularin për dorëzimin e ofertës (paramasa dhe parallogaria) e cila është pjesë e dosjes së tenderit, mirëpo e njejta i përmban të gjitha informatat relevante, të përshkruara në mënyrë të qartë dhe të saktë të lidhura me lëndën e kontratës në fjalë, duke ju mundësuar OE të interesuar për të pasur njohuri të sakta për përgaditjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Ky fakt vërtetohet me provën relevante, formularin në formatin excel për dorëzimin e ofertës (paramasa dhe parallogaria), për të cilën sipas legjislacionit në fuqi në kohën e zhvillimit të këtij

aktiviteti, nenit 18.3 të RRUOPP përcaktohet se ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare.

Prandaj, duke qenë se nuk mund të provohet me asnjë provë relevante arsyetimi i dhënë nga AK për anulim të aktivitetit të prokurimit me pretekstin se gjoja ka ndodhur diçka e paligjshme që nuk mund të riparohet, gjendjen faktike dhe rrethanat e pa sqaruara do t'i pasqyrojmë si në vijim:

1. Formulari për dorëzimin e ofertës (paramasa dhe parallogaria) për aktivitetin në fjalë është e përbërë nga katër pjesë të ndara nga njëra tjetra në paramasa të veçanta, duke u nisur nga: pjesa e parë KRAHU 1; pjesa e dytë KRAHU 2; pjesa e tretë KRAHU 3, si dhe pjesa e fundit, Rekapitullimit total për të tri pjesët e paramasave – krahëve (Për me tepër referoju paramasës që e kemi sjellur si dëshmi).

2. Secila pjesë/paramasë e formularit për dorëzim të ofertës, KRAHU 1, KRAHU 2 dhe KRAHU 3, i përmban të gjitha informatat relevante, të përshkruara në mënyrë të qartë dhe të saktë të lidhura me përshkrimin e punëve, materialeve, njësisë, sasive dhe çmimit për secilin pozicion dhe secilën pjesë/krahë duke përfshirë edhe rekapitullimin total për secilin krahë, duke ju mundësuar OE të interesuar për të pasur njohuri të sakta për përgaditjen e tenderëve pa gabime dhe pa kërkuar informata shtesë.

3. Pjesa e fundit e formularit për dorëzim të ofertës është Rekapitullimi në tri kolona për KRAHU 1, KRAHU 2 dhe KRAHU 3, lidhur me paraqitjen e çmimit të fituar nga rekapitullimi i secilës pjesë/krahë dhe paraqitjen e çmimit total të fituar nga rekapitullimet e tri pjesëve/krahëve. Siç e kemi sqaruar në ankesë, në rekapitullimin total përkitazi krahun 3 ka ekzistuar një lëshim i vogël teknik i trashëguar nga aktivitetet e kaluara sepse në rubrikën e çmimit total që është fituar duke mbledhur çmimin e rekapitullimit të secilit krah, ka munguar formula për llogaritje automatike edhe për rekapitullimin e krahut tre, por pa asnjë problem ka mundur që të shtohet plus krahu tre në mënyrë që çmimi total të llogaritet përmes formulës në mënyrë automatike. Megjithatë, ky lëshim teknik nuk ka penguar/pamundësuar OE llogaritjen ta bëjnë në formë teknike/manuale siç ndodh zakonisht nga OE si masë e sigurisë dhe vigjilencës për t'iu shmangur gabimeve në kalkulim, rrjedhimisht diskualifikimit për gabime aritmetikore më shumë se 2% të vlerës totale. Në këtë mënyrë është vepruar edhe nga ana jonë dhe në këtë kuptim oferta jonë nuk ka asnjë gabim apo mospërputhje ndërmjet çmimit nga rekapitullimet veç e veç për secilin krah dhe çmimit total që është fituar nga çmimet e rekapitullimeve për të tre krahët. Për më tepër duke qenë se nuk ka ndonjë rregull dhe dispozitë ligjore që e kufizon mënyrën se si OE ta kalkulojë ofertën e tyre financiare, mbetet në përgjegjësin, diskrecionin dhe vigjilencën e OE se në çfarë mënyre e kalkulojnë ofertën e tyre financiare.

Prandaj, në vendimet arbitrare si ky, rezulton se anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë duke paraqit pasqyrim të gabuar të gjendjes faktike që nuk përkon në asnjë rrethanë me realitetin, por duke ngritë versione me supozime të pabaza përmes sajimit të fakteve të rreme për t'i përdorur si pretekst për anulim të aktivitetit me qëllim të krijohen disfavore në dëm tonë duke na mohuar të drejtën ligjore për tu shpërblyer me kontratë.

Për t'a argumentuar akoma më shumë se anulimi i aktivitetit nuk është bazuar në gjendjen faktike dhe nuk ka mbështetje ligjore, e dëshmon fakti se përveç se nuk ka një rregull që përcakton/kufizon mënyrën se si OE ta kalkulojnë ofertën e tyre financiare siç deklarua më lartë, për më tepër në dosjen e tenderit nuk ka pasur një kriter të specifikuar për mënyrën e llogaritjes së ofertës financiare nga OE. Në këtë kuptim, çdo diskualifikim që nuk ka mbështetje ligjore, është i padrejtë dhe i paligjshëm. Aq më shqetësuese për neve si OE është fakti, kur ky lëshim teknik, ka qenë i pranishëm dhe është akoma edhe në aktivitete tjera të ardhshme, por asnjëherë nuk ka ndodhur që AK të anulojë asnjë aktivitet prokurimi për këtë shkak.

Shembull konkret është aktiviteti i prokurimit me titull: "Furnizim me materialo Hixhienik – Sanitar" me nr. 651-23-394-1-1-1, i cili ka përfunduar me dhënien e kontratës.

Pra, duke qenë se nxjerrjes së vendimit për anulim të aktivitetit i ka paraprirë pasqyrimi i gabuar i gjendjes faktike që nuk përkon me realitetin, rrjedhimisht rezulton se dispozita e nenit 62 par.1.1 është zbatuar në mënyrë të padrejtë. Për më tepër, arsyetimi për anulim të aktivitetit të prokurimit duke u thirrur në supozime dhe imagjinim të situatave joreale, është i paqëndrueshëm dhe në kundërshtim flagrant me përmbajtjen dhe situatat që i përcakton dispozita e nenit 62 të LPP-së, për faktin se në rastin konkret nuk ka ndodhur asnjë shkelje ligjore. Baza e arsyetimit të paraqitur e paraqet dëshirën dhe qëllimin e inicuesit të aktivitetit, e jo kërkesën dhe qëllimin e këtij ligji, sepse arsyetimi për anulim nuk gjen mbështetje madje në asnjë prej kritereve të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Prandaj, me këtë logjikë të praktikës së anulimit të aktiviteteve të pabazuara në ligj, nëse nuk ndërmerrni masa konkrete për të shmangur devijimeve ligjore, mos u habitni që një ditë AK Komuna e Gjilanit, t'i anulojë aktivitetet edhe për gabime drejtshkrimore.

Nga ana tjetër, sa i përket vlerësimit të ekspertit shqyrtues i cili çuditërisht konstaton se, dosja e tenderit është hartuar në kundërshtim me nenin 27 të LPP-së dhe nenin 47.14 të RRUOPP, mund të them vetëm se vlerësimi i tij nuk është objektiv, i drejtë dhe si i tillë është i pa bazuar në gjendjen faktike dhe kërkesat ligjore, pasi që nuk ekziston as minimumi i vlerësimit real.

Shpresoj që ky vlerësim i ekspertës lind nga mungesa e përvojës në hartimin e ekspertizave në fushën e prokurimit publik, e jo nga ndonjë qëllim tjetër për të krijuar paqartësi dhe manipuluar me të vërtetën duke e vënë në lajthim panelin shqyrtues për të vendosur në dobi të AK-së. Sepse ekspertja para se të ngritë verzione me supozime të pabazuara që e ngatërrojnë gjendjen faktike, do të duhej që t'a analizonte dhe shqyrtonte në tërësi PJESËN C, Formularin për dorëzimin e ofertës e cila është pjesa kryesore e tenderit. Po të vepronte në këtë mënyrë pas asnjë mëdyshje do të vërente se paramasa i plotëson të gjitha kërkesat ligjore pasi që, *në katër pjesët e saj i përmban të gjitha informatat relevante, të përshkruara në mënyrë të qartë dhe të saktë të lidhura me lëndën e kontratës në fjalë, duke ju mundësuar OE të interesuar për të pasur njohuri të sakta për përgaditjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë.*

Në këtë mënyrë, nuk do të ngritëshin supozime të pabaza duke e ngatërruar gjendjen faktike dhe ligjore me qëllim që të ipet përshtypja në mënyrë që të bindet paneli shqyrtues se diçka e paligjshme paska ndodhur, e cila nuk ka ndodh. Kjo për faktin se nuk ka ndodhur asnjë gabim i

vetëm në paramasë. Jemi të bindur se edhe paneli e ka të njohur se nuk konsiderohet gabim, mungesa e formulës automatike për llogaritje në paramasë siç ka ndodhë në rekapitullimin total përkitazi me rezultatin e rekapitullimit tre, pasi pa asnjë problem ka mundur që të shtohet plus krahu tre në mënyrë që të llogaritet në çmimin total të fituar nga rekapitullimet e tre kraheve. Po ashtu kjo nuk është e vetmja mënyrë për kalkulim dhe llogaritje të ofertës sepse llogaritja të bëhet në formë teknike siç ndodh zakonisht nga OE si masë e sigurisë dhe vigjilencës për t'iu shmangur gabimeve në kalkulim. Aq më tepër kur, nuk ka një rregull që përcakton/kufizon mënyrën se si OE ta kalkulojnë ofertën e tyre financiare, e për më tepër edhe në dosjen e tenderit nuk ka pasur një kriter të specifikuar për mënyrën e llogaritjes së ofertës financiare nga OE.

Duke qenë se vlerësimet e ekspertit nuk janë objektive dhe nuk kanë mbështetje faktike dhe ligjore, konsiderojmë se nga paneli nuk duhet të mirren të mirëqena e as të pranueshme dhe të njejtat nuk duhet të kenë ndikim në vendosjen e kësaj lënde.

Poashtu ne ket proces nga ana e AK-se eshte shkelur edhe nenit 40 .3 i RrUOPP-se, per shkak se procesi i vleresimit nuk ka përfunduar ne afatin ligjore (30 dite nga afati i parapare n ligj, por ka zgjatur rreth 37 dite) pa u dhene asnjë sqarim per arsyet e tejzgjatjes. Ky pretendim eshte vërtetuar si i bazuar edhe nga ana e ekspertit shqyrtues.

Nga ana e AK-se, eshte shkelur edhe neni 10 si dhe 11.4 i LPP-se, per shkak se perkunder faktit se kërkesa per qasje ishte aprovuar e njëjta nuk eshte zbatuar me justifikimin duke u thirrur ne sekret afarist per kunder se informatat OE-ve tjere nuk ishin klasifikuar si sekrete afariste sic përcaktohet ne nenin 11.4 te LPP-se. Dua të besoj se paneli shqyrtues, gjatë shqyrtimit kryesor do t'i vrejë këto shpërputhje, kundërthënje dhe besoj se në vendimin e saj do t'i vlerësojë ashtu siç meritojnë të vleresohën.

Gjate seances perfaqesuesi i AK z. deklaroi: Qendron prapa vendimit te saj me arsyetimin e dhene. Ashtu sic u përmend edhe me heret nga përfaq. I OE-se kjo procedur e prokurimit eshte anuluar per sraje se AK, gjate fazes se vleresimit ka konstatuar se ka ndodhur nje gabim ne listen e përshkrimit te cmimieve – paramase, me szaktesisht te rekapitullimi, krahu u trete, andaj bazuar ne rregulloren 001/2022, nenin 44 te saj – formularet standard pika 44.3 ku thuhet se: qellimi i dokumenteve standarde eshte qe te ndihmohn OE-te gjat pergaditjes sse ofertave , deklarata duhet te permbajn kerkesat minimale te përcaktuar ne formular pa ndryshuar ne përmbajtje pa prezantimin e kufizimeve, apo kushtetve shtese ose pa perfshirjen e ndonje kushti te përcaktuar ne AK-ja, ne format standarde, por kompania qe ben deklarat ka te drejten qe te vendos logon emrin e kompanise apo grafit ne krye te faqes apo kudo tjeter ne dokumentin standarde. Pas konstatimit te nje gabimi te till AK-ja, me qellim te trajtimit te barabarte te te gjith OE-ve ka marr vendim per anulimin e kësaj procedure pasi qe gjate vleresimit te ofertave ka konstatuar se disa nga OE-te, kan vërejtur gabimin dhe e kanë korrigjuar duke e llogaritur edhe krahun 3 te rekapitullimit, ndersa OE-te e tjere nuk e kan vërejtur kete qe do te thotë se nuk e kanë llogaritur meqenëse ne faqen e sqarimit te tenderit, nuk ka pasur ne ana e OE-ve te interesuar kerkese per sqarim te tenderit dhe ne si AK nuk e kemi vërejtur si AK, atehere AK-ja ka vendosur të veproji dhe ti trajtoje te gjith

OE-te ne kete procedure ne mënyre te barabarte. E permendi perfaqesi i OE –s se gabimet e tilla ndodhin tek AK-ja, une si zyrtare qe kam pergaditur kete lende dhe sot jam ketu per ta perfaqesuar AK-ne, per nje gabim qe ka ndodhur e qe eshte gabim nga njesia kerkuese unë si zyrtare nuk kam psaur te drejten plotësim apo korrigjim te paramases pasi qe nuk jam kompetente per hartimin e paramases.

Kryetarja e panelit pyet perfaqesuesin e AK-se: a ka pasur ndonje gabim tjetër përbrenda paramases apo gabimi ka ndodhur tek formula per llogaritjen përfundimtare?

Ne përgjigje perfaqesuesi i AK-se deklaron: gabimi ka qene vetem ne përlllogaritjen përfundimtare per krahun e trete, gabime tjera nuk ka pas.

Pyetje per AK-se, lidhur me nje deklarate qe e potencuat tani sa i perket logos a mund te na e sqaroni se per cfarë e patet fjalen, ai dokument a ka nënshkrim, vulen?

Ne përgjigje perfaqesuesi i AK-se deklaron se nuk ka te beje me ndonje dokument te caktuar vetem shpjeguar disa rregulla te pergjithshme se ku OE-te mund te nderhyjne.

Ne vazhdim fjala iu dha ekspertes shqyrtuese znj. Rexhepi e cila ka deklaruar permes email-it se: Sot me datën 28.04.2023 përmes postës elektronike kam pranuar ftesën për seancë për shqyrtim kryesor te ankesës 49/23, andaj po ju joftoj se me datën 02.05.2023 gjendem në pushim vjetor.

Sa i përket Raportit të ekspertizes qendroj prapa raportit dhe njeherit po ju njoftoj se nuk qëndron pretendimi i OE në përgjigje të raportit të ekspertizes, i cili ka deklaruar se nuk jam përgjigjur në të gjitha pretendimet ankimore, sepse edhe pas pranimit të kësaj përgjigje i kam analizuar pretendimet ankimore me cka rezulton se përgjigjet janë dhënë në të gjitha pretendimet ankimore.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha provave, fakteve dhe dokumentacionit të prezantuar për këtë procedurë të prokurimit, në ankesë dhe shkresat e të gjithë aktivitetit të prokurimit në sistemin e e-prokurimit, kontstaon se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, duke u bërë aplikimi i gabuar i kësaj dispozite dhe ligjit material.

Paneli shqyrtues sqaron se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë me arsyetimin se ka ndodhur një gabim i riparueshëm tek lista e përshkrimit –paramasës dhe parallogarisë, pjesa C e dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues analizoj dosjen e tenderit, më saktësisht pjesën C për të cilën AK ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin se ka gabime që nuk janë të evitueshme dhe konstaton se kjo pjesë i përmban të gjitha informatat relevante, të përshkruara në mënyrë të qartë dhe të saktë të lidhura me lëndën e kontratës në fjalë, duke ju mundësuar OE të interesuar për të pasur njohuri të sakta për përgaditjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmën duke respektuar në përpikmëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave dicitinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues
Kimete Gashi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK Komuna Gjilanit,
- 1x1 OE El-Bau" sh.p.k., me seli në Gjilan
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.